

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



Nëntor

Drejtuar nga Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, u mbajt mbledhja konsultative e Bordit të Drejtorëve



Gjatë këtij takimi u diskutuan çështjet kryesore që lidhen me realizimin e projekteve të planifikuara për këtë vit, dinamikën e shpenzimeve buxhetore, si dhe ecurinë e të hyrave vetanake. Po ashtu u shqyrtuan sfidat dhe arritjet në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët, me qëllim të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe cilësisë në punë.

Kryetari z. Imri Ahmeti kërkoi nga drejtorët angazhim maksimal në përmbushjen e objektivave të parashikuara deri në përmbyllje të vitit fiskal, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet drejtorive për realizimin e plotë të planifikimeve për vitin 2025.

Drejtorët e drejtorive raportuan për progresin e projekteve aktuale, sfidat gjatë zbatimit të tyre dhe masat që po ndërmerren për të siguruar përmbushjen e objektivave institucionale.

Kryetari Ahmeti ka pritur në takim ish-administratorin e Komunës së Lipjanit, z. James Rogan



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim ish-administratorin e Komunës së Lipjanit, z. James Rogan, i cili menjëherë pas luftës ka shërbyer si administrator, i caktuar nga përfaqësuesi special i Kombeve të Bashkuara, z. Bernard Kouchner. Gjatë takimit e rikujtuam periudhat pas përfundimit të luftës, kur Lipjani dhe mbarë vendi po kalonin në procesin e rindërtimit dhe të themelimit të institucioneve lokale. Kryetari Ahmeti e falënderoi z. Rogan për angazhimin dhe kontributin e tij të hershëm në formimin dhe zhvillimin e administratës komunale, duke theksuar se puna e tij ka lënë gjurmë në konsolidimin e institucioneve lokale.


“Kontributi i z. James Rogan ka qenë thelbësor në ndërtimin e strukturave të para të administratës komunale dhe në organizimin e tyre. Po ashtu, bashkëpunimi i tij me organizatat ndërkombëtare, të cilat ndihmuan në rindërtimin e fshatrave të dëmtuara gjatë luftës, është një vlerë që e kujtojmë me respekt. Në emër të qytetarëve të Lipjanit, e falënderoj për punën dhe përkushtimin e treguar në atë kohë”, tha kryetari z. Imri Ahmeti.

Ndërsa ish-administratori z. James Rogan falënderoi kryetarin Ahmeti për mikpritjen dhe për zhvillimet pozitive që ka parë në Komunën e Lipjanit.

“Është kënaqësi të rikthehem pas kaq shumë vitesh dhe të shoh një komunë të zhvilluar, me institucione funksionale dhe me një objekt të ri të administratës. Falënderoj kryetarin Ahmeti për mikpritjen dhe për angazhimin e tij në zhvillimin e mëtejshëm të Lipjanit”, ka thënë z. Rogan.

Në përmbyllje të takimit, kryetari Ahmeti i dorëzoi z. James Rogan pllakaten e Komunës së Lipjanit si shenjë mirënjohjeje për kontributin e tij të çmuar në zhvillimin e komunës dhe të administratës lokale.

Konferenca “Women and Youth in Tech 2025”



Konferenca “Women and Youth in Tech 2025”

Komuna e Lipjanit, në bashkëpunim me OSCE, ka mbështetur organizimin e konferencës së parë në Lipjan kushtuar teknologjisë dhe inovacionit “Women and Youth in Tech 2025”.

Ngjarja kishte për qëllim fuqizimin e grave dhe të rinjve në fushën e teknologjisë dhe inteligjencës artificiale, duke ofruar mundësi të reja për mësim, frymëzim dhe bashkëpunim.

Në këtë konferencë morën pjesë të rinj, profesionistë, përfaqësues të institucioneve, bizneseve dhe organizatave partnere, me temën: “Fuqizimi i grave dhe të rinjve në epokën e transformimit digjital”.

Komuna e Lipjanit do të vazhdojë të mbështesë nisma të tilla që fuqizojnë të rinjtë, gratë dhe promovojnë zhvillimin digjital dhe inovacionin në vendin tonë.

Nënkryetari Bytyqi ka pritur në takim Grupin e Auditimit Social



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, ka pritur në takim Grupin e Auditimit Social, ku janë prezantuar gjetjet dhe rekomandimet për katër projektet infrastrukturore të monitoruara në kuadër të procesit të Auditimit Social.

Gjatë takimit, përfaqësuesit e Institutit Demokraci Plus dhe organizatës YAHR, prezantuan rezultatet e punës dhe propozimet për përmirësimin e zbatimit të projekteve.

Nënkryetari Bytyqi falënderoi grupin e auditimit për angazhimin dhe bashkëpunimin, duke theksuar se Komuna e Lipjanit do t'i trajtojë me seriozitet gjetjet dhe rekomandimet, veçanërisht ato që synojnë rritjen e shfrytëzueshmërisë dhe përfundimin e plotë të projekteve publike.

Ndërsa kryesuesi i Grupit të Auditimit Social, z. Bekim Krasniqi, falënderoi Komunën e Lipjanit për bashkëpunimin e treguar dhe qasjen e shpejtë në dokumentet publike, të cilat mundësuan realizimin e Auditimit Social për projektet e monitoruara, të cilat janë financuar nga Granti i Performancës Komunale, ku Komuna e Lipjanit ishte fituese.

Procesi i Auditimit Social ka për qëllim të forcojë dialogun ndërmjet qytetarëve dhe komunës, të avancojë transparencën dhe llogaridhënien institucionale, si dhe të fuqizojë pjesëmarrjen aktive të qytetarëve në monitorimin e investimeve publike.

Në kuadër të këtij Auditimi Social janë monitoruar këto projekte infrastrukturore si “Ndërtimi i murit gabion në Gadime të Ulët”, “Shtëpia muze e veteranëve të UÇK-së në Krojmir”, “Rikonstruksioni i rrugës “Ajet Kozhani” Poturofc – Ribar i Madh” dhe “Rikonstruksioni i rrugës Dobrothinë – Sllavi”. Ky aktivitet zhvillohet në kuadër të projektit “Fuqizimi i qytetarëve përmes Auditimit Social”, që implementohet nga Instituti Demokraci Plus (D+) dhe organizata YAHR Lipjan, me mbështetje nga programi DEMOS.

Nënkryetari Bytyqi ka pritur në takim nxënësit fitues të garës ASEF në Tiranë



Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me Kryesuesin e Kuvendit, z. Daut Azemi, dhe Drejtorin e Arsimit, z. Rasim Hasani, kanë pritur në një takim të veçantë nxënësit e ShFMU “Vëllezërit Frashëri” dhe ShFMU “Migjeni”, të cilët u shpallën fitues në Panairin e Garave ASEF, të mbajtur në Tiranë.

Me këtë rast, Nënkryetari Bytyqi vlerësoi lart punën dhe rezultatet e nxënësve, duke theksuar se sukseset e tyre janë dëshmi e qartë e përkushtimit dhe cilësisë së arsimit në komunën tonë.

“Ju duhet të ndiheni vërtet krenarë, sepse sot keni bërë krenarë të gjithë qytetarët e Lipjanit. Rezultatet që keni arritur janë dëshmi e qartë se puna, përkushtimi dhe serioziteti shpërblehen gjithmonë. Secili prej jush, së bashku me mësimdhënësit dhe shkollën tuaj, e cila vazhdimisht arrin sukses në çdo garë, meritoni vlerësimin më të lartë. Komuna e Lipjanit do të vazhdojë t’ju mbështesë pa hezitim sa herë që paraqitet nevoja, sepse investimi në dije është investim i drejtpërdrejtë në të ardhmen e fëmijëve dhe të komunës sonë”, tha nënkryetari, z. Diamant Bytyqi.

Ndërsa drejtori i shkollës, z. Jakup Bahtiri, së bashku me nxënësit, ka shprehur falënderime për mbështetjen e vazhdueshme të Komunës së Lipjanit, e cila u ka mundësuar pjesëmarrjen në gara të rëndësishme si ASEF. Ai theksoi se ky bashkëpunim i përhershëm motivon shkollën që të vazhdojë me përkushtim dhe profesionalizëm, në mënyrë që së bashku me mësimdhënësit dhe nxënësit të përfaqësojnë denjësisht komunën në secilën garë brenda dhe jashtë vendit.

Shkolla “Vëllezërit Frashëri” këtë vit mori pjesë me 8 projekte inovative, duke arritur rezultate mbresëlënëse në disa fusha mësimore. Të gjitha projektet u vlerësuan me medalje, duke vazhduar traditën e suksesit, përkushtimit dhe cilësisë së kësaj shkolle.

Nga pjesëmarrja në ASEF 2025, shkolla siguroi: vendin e parë me medalje të artë në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze, një medalje të artë dhe një medalje të bronzit në gjuhën gjermane, një medalje të artë, një të argjendtë dhe një të bronzit në lëminë e gjeografisë si dhe një medalje të bronzit në histori. Këto arritje e konfirmojnë edhe një herë traditën e sukseseve të kësaj shkolle dhe përkushtimin e saj ndaj cilësisë në edukim.

Po ashtu suksese të veçanta arriti edhe ShFMU “Migjeni”, e cila u shpërblye me medaljen e artë për projektin “Kulla e Komandantit Legjendar Adem Jashari”. Ky projekt nxori në pah heroizmin dhe sakrificën e familjes Jashari gjatë sulmeve të marsit 1998, duke sjellë një moment krenarie për nxënësit dhe shkollën.

Kryetari Ahmeti ka pritur në takim Këshillin e Bashkësisë Islame në Lipjan



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka pritur në takim delegacionin e Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan, të kryesuar nga kryetari z. Zaim Baftiu. Gjatë takimit, z. Baftiu i uroi kryetarit Ahmeti mandatin e ri, duke vlerësuar punën e tij të deritanishme dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me Bashkësinë Islame.

Kryetari i BIK-ut në Lipjan, z. Baftiu, shprehu mirënjohjen për mbështetjen institucionale që Bashkësia Islame ka marrë ndër vite nga Komuna e Lipjanit.

Ai theksoi se rezultatet dhe vlerësimi i qytetarëve janë pasqyrim i punës së mirë dhe bashkëpunimit të ndërsjellë. Po ashtu, z. Baftiu i dhuroi kryetarit Ahmeti një simbolikë mirënjohjeje, si shenjë vlerësimi për bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ndërsa kryetari z. Ahmeti falënderoi Këshillin e Bashkësisë Islame për urimet dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm. Ai theksoi se institucionet komunale mbeten të përkushtuara për të ndërtuar partneritet të qëndrueshëm me të gjitha mekanizmat lokalë, me qëllim të avancimit të proceseve dhe ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët.



Organizohet orë letrare me artistët e rinj të shkollave fillore të Lipjanit, me rastin e 28 Nëntorit



Komuna e Lipjanit, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, ka organizuar orë letrare me nxënësit e shkollave fillore të komunës, në shenjë nderimi për festën e 28 Nëntorit – Ditës së Flamurit Kombëtar.

Gjatë aktivitetit, nxënësit pjesëmarrës prezantuan krijimet e tyre letrare, përfshirë poezi dhe interpretime artistike, duke shfaqur talentin dhe kreativitetin e tyre. Me këtë rast, Komuna e Lipjanit ndau mirënjohje për artistët e rinj, si shenjë respekti dhe vlerësimi për talentin dhe kontributin e tyre në fushën e krijimtarisë letrare.

DKRS falënderon të gjitha shkollat dhe mësimdhënësit për bashkëpunimin dhe angazhimin e tyre në realizimin e këtij aktiviteti.

Kryetari Ahmeti bën homazhe në nder të festës së 28 Nëntorit



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë, me rastin e festës së 28 Nëntorit, Ditës së Flamurit Kombëtar, ka bërë homazhe dhe ka vendosur buqetë me lule pranë lapidarit të Komandantit Legjendar Adem Jashari.

Me këtë rast, kryetari Ahmeti theksoi se 28 Nëntori është Dita e Flamurit Kombëtar, ditëlindja e Komandantit Legjendar Adem Jashari dhe dita e daljes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ngjarje që e bëjnë këtë datë një ditë historike për popullin shqiptar. Ai nënvizoi rëndësinë e tyre në ruajtjen e identitetit, lirisë dhe unitetit kombëtar.



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508